

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *Arti muzikor*, lëndë zgjedhore për vitin IV (e katërt) për arsimin e mesëm - gjimnaz, për vitin shkollor 2020/2021.

1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën *Arti Muzikor* lëndë zgjedhore për vitin IV (e katërt) për arsimin e mesëm në gjimnaz, bazohet në qëllimet / rezultatet e pritura të parashikuara me programin mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet në përputhje me planin mësimor.

Me programin e shkurtuar përcaktohen njësité e caktuara dhe njësité mësimore që duhet të realizohen në 145 ditë mësimore, gjatë së cilës duhet të merret parasysh fondi javor i orëve të caktuara në programin e rregullt, përkatësisht për lëndën mësimore me 2 orë në javë parashikohen 58 orë në programin e shkurtuar me kohëzgjatje të orës mësimore prej 35 minuta.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. Pasqyra e temave dhe tërësive tematike

Tema/Fusha

1. SHKRIMLEXIMI MUZIKOR

Tërësitë tematike

- Shkrimleximi muzikor

Tema/Fusha

2. INSTRUMENTET MUZIKORE

Tërësitë tematike

- Instrumentet me harqe;
- Instrumentet frymore;
- Instrumentet me tela;
- Instrumente me taste, dridhje;
- Instrumentet me goditje;
- Instrumente muzikore për fëmijë.

Tema/Fusha

3. DËGJIMI I MUZIKËS

Tërësitë tematike

- Dëgjimi i muzikës

Tema/Fusha

4. INTERPRETIMI VOKAL

Tërësitë tematike

- Këngë për fëmijë
- Këngë artistike
- Këngë të njohura (popullarizuara)
- Fragmente të veprave nga autorë të njohur

3.Rekomandimet didaktike

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën Arti muzikor për vitin IV (e katërt) për arsimin e mesëm - gjimnaz do të realizohet për 145 ditë në vitin shkollor 2020/2021 në 58 orë mësimore në kohëzgjatje të orës mësimore prej 35 minuta. Në këtë program nuk është dhënë numri i orëve dhe përmbajtjeve, për arsye se vetë përmbajtjet dalin nga tërësitë tematike dhe qëllimet konkrete, si dhe në programin e rregullt mësimor, me çka i jepet mundësia mësimdhënësit të shprehë kreativitetin e tij dhe përshtatjen ndaj kushteve materiale-teknike dhe hapësinore, aktiviteteve të ndryshme dhe përshtatjen e mësimit me gjendjen e jashtëzakonshme në korniza botërore të krijuar nga virusi Kovid-19.

Në përpilimin e planifikimeve për realizimin e programeve mësimore për lëndën mësimore arti muzikor, lëndë zgjedhore për vitin III (e tretë) në arsimin e mesëm -gjimnaz, nuk është paraparë qasja e unifikuar. Nevojitet që secili mësimdhënësi individualisht të bëjë gërshetimin e përmbajtjeve mësimore të temave të ngjashme dhe të ndryshme sipas nevojave reale për realizimin e mësimit, njëkohësisht duke pasur kujdes në lidhshmërinë logjike të tyre mes veti. Rekomandohet mësimdhënësi gjatë realizimit të orës mësimore në të cilën ka të integruar dy ose më shumë përmbajtje mësimore të ketë kujdes në vëllimin e materies mësimore.

Mësimdhënësi në planifikimin dhe realizimin e njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, konceptet e caktuara, metodat dhe aktivitetet të caktuara në mësimin e programit rregullt, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e mësimit prej 35 minutash. Ndjekjen e të arriturave të nxënësve secili mësimdhënësi individualisht duhet ta integrojë në kuadër të orëve të planifikuara për realizim, duke përdorë metoda, teknika dhe instrumente të ndryshme.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin mësimor të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadrin mësimor të dhënë në programin mësimor të rregullt.

Programin mësimor të shkurtuar për lëndën arti muzikor lëndë zgjedhore për vitin IV (e katërt) në arsimin e mesëm – gjimnaz, e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska
